



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKÄ KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Punëdhënësi / Profitor / Received / Delivered	18.06.2021	1 viti god year	
Organ / Shërbimi / Organ / Jedinstvo / Org / Unit	H / Prot H / Prot Prot No	Shtojcë / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKRIMSHKIC	3191/2021		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.439/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1407/20, të datës 20.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datën 21.05.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.160/2020 të datës 15.06.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë, rr."Bregu i diellit", zona e lindjes, Llamella 9, hyrja 6, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.SHFUQIZOHET** Vendimi me numër Nr.36/2020 i datës 14.12.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

**II.OBLIGOHET** Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që do të krijohet Ad Hoc për rastin konkretë sipas legjislacionit të vjetër, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të bëjë **Rishqyrtimin** e lëndës për ankesën e ankuesit

**III.OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, t'i ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi është punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas akt emërimit me numër 135 të datës 11.04.2014, në pozitën "Zyrtar i lartë për të drejtat e njeriut", në Departamentin për Çështje ligjore dhe traktate, sipas vendimit me numër ZSP/061/14 të datës 08.04.2014, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil, të lëshuar nga Ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi bazën e marrëveshjes për transferim të përhershëm të nëpunësit me numër Nr.234 të datës 08.04.2014, nga pozita "Udhëheqës i Divizionit për monitorim dhe vlerësim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, marrëveshje kjo e cila është nënshkruar ndërmjet dy Sekretarëve të Përgjithshëm të të dyja ministrive.

Me datën 30.12.2015, Ministri i Punëve të Jashtme ka nxjerrë vendimin me numër Nr.053/2015, sipas të cilit ankuesi me gradën Sekretar i parë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, emërohet si përfaqësues i Republikës së Kosovës në "Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë" (MARRI), me seli në Shkup-Maqedoni.

Me datën 24.05.2019, Ministri i Punëve të Jashtme ka nxjerrë vendimin me numër Nr.256, sipas të cilit i 'u ka vazhduar mandati i dytë 4 vjeçar si përfaqësues i Republikës së Kosovës në "Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë" (MARRI), me seli në Shkup/Maqedonia Veriore.

Me datën 31.03.2020, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.138/2020, sipas të cilit ankuesi me gradën Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup/Republikën e Maqedonisë së Veriut, pas përfundimit të mandatit të kthehet/tërhiqet nga misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku sistemimi dhe caktimi i vendit të punës së ankuesit duhet të bëhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër Nr.138/2020 të datës 31.03.2020, të Ministrit të Punëve të Jashtme për tërheqjen/kthimin nga misioni, me datën 29.04.2020, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit Nr.774, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme, me datën 14.05.2020, ka nxjerrë vendim sipas të cilit ankesën e ankuesit Bilall Billalli, e ka refuzuar si të pabazuar.

Me datën 13.05.2020, Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.198/2020, sipas të cilit e ka shtyrë ekzekutimin e vendimeve, që i referohen tërheqjes së diplomatëve nga misionet diplomatike apo postet konsullore, deri me datën 30.08.2020, për arsye të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga virusi covid-19.

Me datë 15.05.2020, ankuesi ka parashtruar ankesën me numër të protokollit Nr.816, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Me datë 15.06.2020, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me datë 10.07.2020, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.313/2020, sipas të cilit ankuesi me gradën diplomatike Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup/Republikën e Maqedonisë së Veriut, kthehet/tërhiqet nga misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku sistemimi dhe caktimi i vendit të punës së ankuesit duhet të bëhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Me datë 01.09.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.129/2020, sipas të cilit ankuesin pas kthimit nga misioni diplomatik si Këshilltar, i cili ka shërbyer ne Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shkup/Republikën e Maqedonisë, për nevoja të Ministrisë ,e ka sistemuar në pozitën "Zyrtar i lartë për Shtete dhe Organizata Ndërkombëtare/Evropë Lindore-Departamenti për Evrope dhe BE, duke u bazuar në vendimin me numër Nr.313/2021, te datës 10.07.2020, të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.06.2020, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërsa Këshilli me datën 09.07.2020, ka pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme ,përgjigjen në kërkesë me numër protokoll: 1331/2020, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr. Prot:1163/2020 e datës 15.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 20.07.2021; E-maili zyrtar i datës 16.06.2020; E-maili zyrtar i datës 15.06.2020; Vendim me numër Nr.313/2020 i datës 10.07.2020 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ankesë e ankuesit me numër Nr.774 e datës 29.04.2020, për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim me numër Nr.053/2015 i datës 30.12.2015 i Zëvendës Kryeministrit të Parë-Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendim me numër Nr.256 i datës 24.05.2019 i Zëvendës Kryeministrit të Parë-Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendim me numër Nr.138/2020 i datës 31.03.2020 i Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ankesë e ankuesit me numër Nr.816 e datës 15.05.2020 për Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim i datës 14.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim me numër Nr.256/2019 i datës 24.05.2019 i Zëvendës Kryeministrit të Parë-Ministrit të Punëve të Jashtme ; Vendim me numër Nr.138/2020 i datës 31.03.2020 i Ministrit te Punëve te Jashtme dhe Diasporës; Vendim me numër Nr.198/2020 i datës 13.05.2020 i Ministrit në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-maili zyrtar i datës 15.06.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.06.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 03.06.2021 nga Ministria e Punëve të Jashtme me shkresat bashkangjitura; Vendim me numër Nr.129/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt emërim i ankuesit me numër 135 i datës 11.04.2014; Marrëveshje për transferim të nëpunësit e datës 08.04.2014, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendim me numër ZSP/061/14 i datës 08.04.2014 i Ushtrueses së detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë se Punëve të Jashtme; Përgjigje në ankesë e datës 08.07.2020 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në **rishqyrtim**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë vendimin me numër 36/2020 të datës 14.05.2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 29.04.2020, si te pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar vendimin me numër 36/2020, të datës 14.05.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka konstatuar se: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 04.05.2020, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.38/2020, për plotësim ndryshimin e vendimit me numër Nr.52, të datës 03.05.2018, të përbërjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku anëtari i Komisionit është zëvendësuar me nëpunësin anëtarë (ad hoc), me arsyetimin se i njëjti është caktuar të shërbejë në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Dyseldorf/Gjermani, vendim ky i nxjerrë në kundërshtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"3. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore, emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm apo nga pozitave ekuivalente të institucioneve përkatëse në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor"*, sepse nuk janë dhënë e ofruar dëshmi dhe prova të mjaftueshme, në kuptimin se në cilën periudhë anëtari është emëruar të shërbejë në Konsullatën e Përgjithshme në Dyseldorf/Gjermani, e duke caktuar anëtarin tjetër anëtar ad hoc të këtij komisioni. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se në këtë kontekst organi i punësimit, nuk ka ofruar prova dhe fakte të mjaftueshme, që dëshmojnë se anëtari gjatë periudhës së shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës së ankuesit, a ka qenë i angazhuar me detyra ende në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, apo ka qenë i ngarkuar me punë në mision diplomatik, e që kjo situatë për Kolegjin ka qenë e pa qartë, sepse nuk dihet periudha e saktë e shkuarjes së nëpunësit në mision diplomatik, me qëllim që të vërtetohet arsyeshmëria juridike e ndërrimit të një anëtari në komision të ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të lëndës, ka konstatuar se: ankuesi me datën 15.05.2020, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit Nr.Prot.816 të datës 15.05.2020, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, gjë e cila nuk është shqyrtuar fare nga ana e Komisionit, e në kundërshtim me nenin 131 paragrafin 1 e 2 të Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: *"1. Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhë të parë nga organi kompetent publik. 2. Organi kompetent publik fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ. Nëse është e nevojshme, organi kompetent publik mund të*

*kryejë shqyrtime (hetime) administrative shitesë”, sepse ankuesi në këtë ankesë ka ofruar dhe paraqitur dëshmi dhe prova të reja të cilat për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, kanë qenë kusht për shqyrtimin e saj dhe vendosjen në mënyrë meritore. Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka qenë i obliguar që ankesën e ankuesit ta shqyrtoj pas parashtrimit të provave dhe fakteve të reja nga ana e ankuesit, obligim ky që rrjedh edhe nga neni 9 paragrafi 7 i Rregullores NR.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku theksohet se: “Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës”.*

Bazuar në të lartëcekurat dhe duke pas parasysh që pas marrjes së vendimit me numër 36/2020 të datës 14.05.2020, nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kanë ndodhur rrethana të reja lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, është i obliguar që të vlerësoj të gjitha provat e bashkangjitura të lëndës, duke marrë parasysh edhe rrethanat e reja të rastit dhe të vendos në mënyrë meritore për ankesën e ankuesit.

Komisioni i ankesave duhet të krijohet ad hoc sipas legjislacionit të vjetër respektivisht ligjit të shërbimit civil, nga se kemi të bëjmë me një vendim të atakuar nga ankuesi që është marrë në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i vjetër i shërbimit civil dhe se me rastin e rishqyrtimit të rastit duhet të veprohet përmes komisionit të ankesave të krijuar sipas legjislacionit të vjetër të shërbimit civil


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.439/2021, datë 18/06/2021

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

